

URDHËR
Nr. 164, datë 8.9.2021

PËR SHPALLJEN E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË
NDRYSHIMEVE NË SNK 12 “TATIMET MBI TË ARDHURAT”

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”.
2. Ndryshimet e SNK 12, të publikuara në maj 2021, kanë datë efektive 1 janarin 2023. Aplikimi më i hershëm është lejuar duke dhënë shënime shpjeguese për këtë fakt.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

**Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin
nga një transaksion i vetëm**

Ndryshime në SNK 12

Ndryshime të SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat

Janë ndryshuar paragrafët 15, 22 dhe 24. Janë shtuar paragrafët 22A dhe 98J-98L. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Njohja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra

Diferencat e përkohshme të tatueshme

- 15 Një detyrim tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme, përveç rasteve kur detyrimi tatimor i shtyrë krijohet nga:
- (a) njohja fillestare e emrit të mirë; ose
 - (b) njohja fillestare e një aktivi ose detyrimi në një transaksion i cili:
 - (i) nuk është një kombinim biznesi; ~~dhe~~
 - (ii) në kohën e transaksionit, nuk ndikonte as në fitimin kontabël dhe as në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme); ~~dhe~~;
 - (iii) në kohën e transaksionit, nuk sjell diferenca të barabarta të përkohshme tatimore dhe të zbritshme.

...

Njohja fillestare e një aktivi ose detyrimi

- 22 Një diferencë e përkohshme mund të krijohet nga njohja fillestare e një aktivi ose një detyrimi, për shembull, në qoftë se një pjesë ose e gjithë kosto e një aktivi nuk do të jetë e zbritshme për qëllime tatimore. Metoda kontabël për këto diferenca të përkohshme varet nga natyra e transaksionit i cili ka çuar në njohjen fillestare të aktivit ose detyrimit:
- (a) në një kombinim biznesi, një njësi ekonomike njeh çdo detyrim ose aktiv tatimor të shtyrë dhe ky ndikon në shumën e emrit të mirë ose në shumën e fitimit që njihet si rezultat i çmimit të rastit (shih paragrafin 19);
 - (b) në qoftë se transaksioni ndikon qoftë në fitimin kontabël apo atë të tatueshëm, ose sjell diferenca të barabarta të përkohshme tatimore dhe të zbritshme, një njësi ekonomike njeh çdo detyrim ose aktiv tatimor të shtyrë dhe njeh shpenzimin ose të ardhurën tatimore të shtyrë që rezultojnë, në pasqyrën e të ardhurave (shih paragrafin 59);
 - (c) në qoftë se transaksioni nuk është një kombinim biznesi, ~~dhe~~ nuk ndikon as në fitimin kontabël e as në fitimin e tatueshëm dhe nuk sjell diferenca të barabarta të përkohshme tatimore dhe të zbritshme, një njësi ekonomike, në mungesë të përjashtimeve të parashikuara në paragrafët 15 dhe 24, do të njohë detyrimin ose aktivin tatimor të shtyrë që rezultojnë dhe do të rregullojë vlerën kontabël neto të aktivit ose detyrimit me të njëjtën shumë. Këto rregullime mund të bëjnë që pasqyrat financiare të ishin më pak transparente. Prandaj, ky Standard nuk lejon që një njësi ekonomike të njohë detyrimin ose aktivin tatimor të shtyrë që rezultojnë, si nga njohja fillestare ose edhe më pas (shih shembullin më poshtë). Për më tepër, njësi ekonomike nuk njeh ndryshimet e mëpasshme në detyrimin ose aktivin tatimor të shtyrë të panjohur me amortizimin e aktivit.

...

- 22A Një transaksion që nuk është një kombinim biznesi mund të çojë në njohjen fillestare të një aktivi dhe një detyrimi dhe, në kohën e transaksionit, nuk prek as fitimin kontabël dhe as fitimin e tatueshëm. Për shembull, në datën e fillimit të një qiraje, një qiramarrës zakonisht njeh një detyrim të qirasë dhe shumën përkatëse si pjesë e kostonë së një aktivi me të drejtë përdorimi. Në varësi të ligjit tatimor në fuqi, diferenca të përkohshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme mund të lindin në njohjen fillestare të aktivit dhe detyrimit në një transaksion të tillë. Përjashtimi i parashikuar nga paragrafët 15 dhe 24 nuk zbatohet për

diferenca të tilla të përkohshme dhe një njësi ekonomike njeh çdo aktiv apo detyrim tatimor të shtyrë që do rezultonte.

...

Diferencat e përkohshme të zbritshme

24 Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme për aq sa ato ka mundësi të mbulohen nga fitimi i tatueshëm përkundrejt të cilit diferenca e përkohshme e zbritshme do mund të përdoret, përveç rastit kur aktiv i tatimor i shtyrë krijohet nga njohja fillestare e një aktivi ose detyrimi në një transaksion që:

- (a) nuk është një kombinim biznesi; dhe
- (b) në kohën e transaksionit, nuk ndikonte as në fitimin kontabël dhe as në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme); dhe
- (c) në kohën e transaksionit, nuk sjell diferenca të barabarta të përkohshme tatimore dhe të zbritshme.

...

Data e hyrjes në fuqi

...

98J Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet ose detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm, i publikuar në maj 2021, ka ndryshuar paragrafët 15, 22 dhe 24 dhe ka shtuar paragrafin 22A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime në përputhje me paragrafët 98K-98L për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më 1 janar 2023 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

98K Një njësi ekonomike do të zbatojë Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm për transaksionet që ndodhin në, ose pas fillimit të periudhës më të hershme krahasuese të paraqitur.

98L Një njësi ekonomike që zbaton Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet ose detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm, gjithashtu duhet që në fillim të periudhës më të hershme krahasuese të raportuar:

- (a) të njohë një aktiv tatimor të shtyrë - për aq sa është e mundur të ketë përfitime tatimore të cilat do mund të përdoren kundrejt diferencës së përkohshme të zbritshme - dhe një detyrim tatimor të shtyrë për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme dhe tatimore të shoqëruar me:
 - (i) aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime të qirasë financiare; dhe
 - (ii) fondet e nxjerrjes nga përdorimi, restaurimi dhe detyrime të tjera të ngjashme dhe shumat përkatëse të njohura si pjesë e kostos së aktivit në fjalë; dhe
- (b) të njohë efektin kumulativ të zbatimit fillestar të këtyre ndryshimeve si një rregullim në tepërcën e fitimeve të pashpërndara (ose në një element tjetër përbërës të kapitalit më të përshtatshëm) në atë datë.

Ndryshim në SNRF1 Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Është shtuar paragrafi 39AH. Në Shtojcën B është ndryshuar paragrafi B1 dhe janë shtuar paragrafi B14 dhe titulli përkatës. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Data e hyrjes në fuqi

39AH *Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm, i publikuar në maj 2021, ka ndryshuar paragrafin B1 dhe ka shtuar paragrafin B14. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2023 e më pas. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.*

Shtojca B

Përfjashtime në zbatimin retrospektiv të SNRF-ve të tjera

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e kësaj SNRF.

B1 Një njësi ekonomike do të zbatojë përfjashtimet në vijim:

...

(g) huatë qeveritare (paragrafët B10-B12); ~~dhe~~

(h) kontratat e sigurimit (paragrafi B13); dhe

(i) tatimin e shtyrë që lidhet me detyrimin për qiratë, ç'vendosjen, rikthimin në gjendjen e mëparshme dhe detyrime të ngjashme (paragrafi B14).

...

Tatimi i shtyrë në lidhje me qiratë dhe fondet e nxjerrjes nga përdorimi, restaurimi dhe detyrime të ngjashme

B14 Paragrafët 15, dhe 24 të SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat lejon një njësi ekonomike të bëjë përfjashtim nga njohja e një aktivi apo detyrimi të shtyrë tatimor në rrethana të caktuara. Pavarësisht nga ky përfjashtim, një njësi ekonomike si miratues për herë të parë i SNRF-ve, duhet të njohë një aktiv tatimor të shtyrë - për aq sa është e mundur të ketë përfitime tatimore të cilat do përdoren kundrejt diferencave të përkohshme të zbritshme - dhe të njohë një detyrim të shtyrë tatimor për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme dhe tatimore të shoqëruar me:

(a) aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime të qirasë financiare; dhe

(b) fonde të nxjerrjes nga përdorimi, restaurimi dhe detyrime të tjera të ngjashme dhe shumat përkatëse të njohura si pjesë e kostos së aktivit në fjalë.

